



## Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH .nr.586/20

**PANELI SHQYRTUES**, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Nuhi Paçarizi - Kryetar, z. Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar , duke vendosur sipas ankesës së parashtuar nga operatori ekonomik: “Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K ” Pejë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , ku është rekomanduar për kontratë OE: “Marisa SH.P.K Compani & Murseli SH.P.K” - Gjakovë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë” , me nr. të prok : 632-20-1596-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” , më datën: 25.09.2020, mori këtë:

### V E N D I M

**I.APROVOHET**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorëve ekonomik: “Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K ”- Pejë , kundër njoftimit për dhënie të kontratës , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë” , me nr. të prok : 632-20-1596-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” ,

**II.ANULOHET**, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë” , me nr. të prok : 632-20-1596-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

**III.** Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

**IV.** Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorëve ekonomik ankues: “Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K ”- Pejë , aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i depozitës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A R S Y E T I M

Operatorët ekonomik ankues: Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K ”- Pejë , si palë të pa kënaqura kanë deponuar ankesë në OSHP, me 24.08.2020 me nr. 586/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës , ku është rekomanduar për kontratë OE: “Marisa SH.P.K Compani & Murseli SH.P.K” - Gjakovë , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i shtegut për ecje dhe çiklizëm Brekoc-Devë” , me nr. të prok : 632-20-1596-5-2-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ “KK-Gjakovë” , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 1 , 2 , 6 , 7 , 10 , 51 , 52 , 59 , 60 , 66 , 69 , 26 , 28 , 41 , 72 , si dhe neni 85 i LPP-së, parag.4, neni 39 i RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 14.09.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

**PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES:** Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K ”- Pejë ,

**Përgjigje ne pretendimin nr. 1 .** Duke u mbështetur në kriterin kryesor të dosjes së tenderit Çmimi më i ulët, shihet se vendimi i AK është ne kundërshtim me këtë kriter por edhe me vet dispozitat e LPP dhe ndryshimet e tij. Për më tepër shihet se ne kemi qenë grup i operatorëve ekonomik që kemi plotësuar kushtet dhe kriteret për dhënie të kontratës. Njëherësh edhe sipas procesverbalit të hapjes shihet se ne si OE kemi ofruar tender dukshëm me çmim më të ulët sesa OE e tjerë. Edhe nga njoftimi për vendim të datës



22.06.2020 shihet se me vendimin e parë kemi qenë të përzgjedhur nga AK si operator i favorshëm, prandaj për ne është e pakuptueshme se si ne një tender fillimisht jemi shpall te përgjegjshëm dhe me te favorshmit ndërsa ne rivlerësim me dokumentacion te njëjtë me pajisje te njëjta dhe me staf te njëjtë shpallemi si të papërgjegjshëm.

Përgjigja e AK në kërkesën për rishqyrtim:

Gjatë procesit të Ri-vlerësimit, është vërejtur se ju keni prezantuar vetëm një cilindër. Cilindri tjetër nuk figuron në listën e mjeteve dhe për të nuk është prezantuar dëshmi, përveç kësaj lista e pajisjeve e ngarkuar nga ju në sistem, është lista e mjeteve e përpiluar për një projekt tjetër Çabrat -Jahoc (këto nuk janë vërejtur nga Komisioni paraprak).

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe vlerësimit të pretendimeve, këtë pretendim të OE ankuesit e gjënë të pa bazuar dhe pajtohet me rivlerësimin e AK-së, sepse sipas RRUOPP-së 39.8 AK duhet të dërgojë "Kërkesë për sqarim të tenderit".

Nëse gjatë procesit të vlerësimit/rivlerësimit mungojnë përshkrime të detajuara apo të qarta si dhe mungojnë pajisjet sipas kërkesës, përveç kësaj lista e mjeteve e përpiluar për një projekt tjetër-Çabrat -Jahoc, atëherë pa kërkuar sqarim Refuzo tenderin, shih më poshtë.

Andaj AK nuk ka pas arsye që të kërkoj sqarime shtesë lidhur me specifikacionin ose pajisjet.

|                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |                                                     |    |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------|----|
| Mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara dhe katalogu<br>( <b>"specifikimit teknik"</b> – AK përcakton kërkesat minimale dhe maksimale te një produkti, ndërsa OE duhet te dorëzoj specifikimin e detajuar te mallrave te ofruara. Përveç ne raste kur OE nuk mund te dorëzoj specifikimin teknik te një produkti te caktuar p.sh. peme/perime etj. OE dorëzon deklaratën ku deklaron se mallrat do te jene ne përputhje me specifikimin e kërkuar) | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 28 |
| Është dorëzuar specifikacioni teknike për mallrat e ofruara por mungon katalogu                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | Mund te kërkohen informata sqaruese                 | 69 |
| Është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                | Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm | 69 |

**Përgjigje ne pretendimin nr. 2 .** AK ndër kriteret e kërkuara ne njoftimin për kontratë tek pika 9.1 dhe 9.2 për staf Profesional ka kërkuar një ing. Konstruktiv dhe një ing. Gjeodezisë për të cilët OE duhet ti kenë te bashkangjitura kontratat, Diplomat, CV dhe referencat e punës. OE i shpallur fitues nuk ka pas diplomën e Ing. Gjeodezisë.

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim:

Grupit të Operatorëve Ekonomik: “Marisa”sh.p.k.&“Company Murseli” sh.p.k.,ju mungon diploma e gjeodetit, nuk qëndron, sepse Grupi i Operatorëve Ekonomik“ Marisa” sh.p.k. &“ Company Murseli”sh.p.k, ka prezantuar diplomën e gjeldetit dhe e njëjta është e ngarkuar në sistem tek Stafi profesional i Inxhinierëve; Eksperti Shqyrtues pas verifikimit të Ofertës së OE të rekomanduarit në E-Prokurim, pretendimin e OE ankuesit e gjënë të pa bazuar me faktin se Diploma e Gjeodetit është e ngarkuar tek Stafi profesional i Inxhinierëve po ashtu janë të ngarkuara sipas kërkesës 9.1 dhe 9.2.

**Përgjigje ne pretendimin nr .3.** Gjithashtu OE i përzgjedhur për stafin teknik ka prezantuar vetëm listat e punëtorëve, ndërkaq kontratat iu mungojnë dhe te njëjtat nuk i ka dorëzuar. Edhe pse fajin e kishin të emërtuar “listat dhe kontratat”, atyre iu mungonin kontratat.

Përgjigja e AK në kërkesën për rishqyrtim:

Grupit të Operatorëve Ekonomik“Marisa”sh.p.k.&“Company Murseli” sh.p.k., ju mungojnë kontratat e stafit teknik, nuk qëndron, sepse të njëjtat me dt. 24.07.2020, i janë kërkuar me nenin 72, të LPP-së. Grupi i Operatorëve Ekonomik" Marisa”sh.p.k. & “Company Murseli” sh.p.k. , me dt. 25.07.2020, i ka ngarkuar në sistem(shihte funksioni “Dokumentet tjera”).

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjënë të pa bazuar, për arsye se gjatë procesit të rivlerësimit AK ka kërkuar sqarim lidhur me kontratat e punëtorëve, dhe OE i rekomanduar i ka bashkangjitur, dhe vlen të theksohet se meqë Lista e punëtorëve ka qenë e ngarkuar në ofertë dhe se kontratat janë të përpiluara me një afat të pa caktuar d.m.th nuk janë kontrata mbi vepër për Aktivitetin në fjalë por Kontratat e ngarkuara konfirmojnë se punëtorët në listën e punëtorëve janë duke punuar që nga viti 2014, çka do të thotë se ato kontrata kanë ekzistuar dhe vetëm janë bashkangjitur. Andaj Eksperti Shqyrtues sqaron se AK ka vepruar konform LPP-së dhe RRUOPP-së, Citat:” 39.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 te LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve te OE. 39.6 AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 39.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet.

**Përgjigje ne pretendimin nr .4.** Por njëri nga operatorët e OE te përzgjedhur kishte certifikatën e



vjetërsuar të biznesit edhe pse ajo me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV 01/2019 të datës 12.04.2019 PËR CAKTIMIN E KËRKESAVE, KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E NR UNIK të shpallur në ARBK është kërkuar të ndërrohen certifikatat e vjetra me të ato të reja të cilat e përmbajnë tanimë NUMRIN UNIK IDENTIFIKUES.

Përgjigja e AK në kërkesën për rishqyrtim:

Njëri nga anëtarë të konzorciumit kishte certifikatën e vjetruar të biznesit, për ne ka qenë apo më mirë të themi e kemi konsideruar devijim të vogël.

Eksperti Shqyrtues Pretendimin e OE ankuesit e gjënë të pa bazuar, me faktin se ky devijim i vogël jo material nuk ndikon në ndryshim ose vendimmarrje.

Eksperti Shqyrtues si përfundim konsideron se ankesa e OE ankuesit është e pa bazuar dhe se AK ka vepruar konform LPP-së dhe RRUOPP-së gjatë procesit të rivlerësimit.

**Mendimi i ekspertit shqyrtues :** Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të refuzohet si e pa bazuar dhe se Vendimi i AK-së për dhënie të kontratës të mbetet në fuqi.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 14.09.2020 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues me datë 15.09.2020 , me anë të parashtrësës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Operatori Ekonomik, me datë: 16.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertës shqyrtuese.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 25.09.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit profesional deklarimit të palëve në

procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës

**Lidhur me pretendimin e ankuesit se** duke u mbështetur në kriterin kryesor të dosjes së tenderit Çmimi më i ulët, shihet se vendimi i AK është në kundërshtim me këtë kriter por edhe me vet dispozitat e LPP dhe ndryshimet e tij. Për më tepër shihet se në kemi qenë grup i operatorëve ekonomik që kemi plotësuar kushtet dhe kriteret për dhënie të kontratës. Njëherësh edhe sipas procesverbalit të hapjes shihet se në si OE kemi ofruar tender dukshëm me çmim me të ulët sesa OE e tjerë. Edhe nga njoftimi për vendim të datës 22.06.2020 shihet se me vendimin e parë kemi qenë të përzgjedhur nga AK si operator i favorshëm, prandaj për ne është e pakuptueshme se si në një tender fillimisht jemi shpall të përgjegjshëm dhe me të favorshmit ndërsa në rivlerësim me dokumentacion të njëjtë me pajisje të njëjta dhe me staf të njëjtë shpallemi si të papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues sqaron se arsyeja e shpalljes se OE ankues si të pa përgjegjshëm nga ana e AK-se është se Gjatë procesit të Ri-vlerësimit, është vërejtur se ju keni prezantuar vetëm një cilindër. Cilindri tjetër nuk figuron në listën e mjeteve dhe për të nuk është prezantuar dëshmi, përveç kësaj lista e pajisjeve e ngarkuar nga ju në sistem, është lista e mjeteve e përpiluar për një projekt tjetër Çabrat -Jahoc (këto nuk janë vërejtur nga Komisioni paraprak).

Andaj paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit AK mund të kërkojë sqarime për këtë pikë duke pasqyruar faktin se dispozitat e LPP-se dhe as të RROUOPP nuk e ndalojnë një gjë të tillë, prandaj me rastin e rivlerësimit AK mund të kërkojë sqarime nga OE në fjalë në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se Grupit të Operatorëve Ekonomik: “Marisa”sh.p.k.&“Company Murseli” sh.p.k. i mungon diploma e gjeodetit.

**Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues konstaton se** AK ndër kriteret e kërkuara në njoftimin për kontratë tek pika 9.1 dhe 9.2 për staf Profesional ka kërkuar një ing. Konstruktiv dhe një ing. Gjeodezisë për të cilët OE duhet të kenë të bashkangjitura kontratat, Diplomat, CV dhe referencat e punës. Grupi i Operatorëve Ekonomik “Marisa” sh.p.k. & “Company Murseli”sh.p.k, ka prezantuar diplomën e gjeodetit dhe e njëjta është e ngarkuar në sistem tek Staf i profesional i Inxhinierëve, ky fakt është vërtetuar pas verifikimit të Ofertës së OE të rekomanduarit në E-Prokurim, andaj pretendimi i OE ankuesit është i pa bazuar sepse Diploma e Gjeodetit është e ngarkuar tek Staf i profesional i Inxhinierëve.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se OE i përzgjedhur për stafin teknik ka prezantuar vetëm listat e punëtorëve, ndërkohë kontratat iu mungojnë dhe të njëjtat nuk i ka dorëzuar. Edhe pse fajllin e kishin të emërtuar “listat dhe kontratat”, atyre iu mungonin kontratat.



Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se gjatë procesit të rivlerësimit AK ka kërkuar sqarim lidhur me kontratat e punëtorëve, dhe OE i rekomanduar i ka bashkangjitur kontrata për punëtor dhe vlen të theksohet se meqë Lista e punëtorëve ka qenë e ngarkuar në ofertë dhe se kontratat janë të përpiluara me një afat të pa caktuar d.m.th nuk janë kontrata mbi vepër për Aktivitetin në fjalë por Kontratat e ngarkuara konfirmojnë se punëtorët në listën e punëtorëve janë duke punuar që nga viti 2014, çka do të thotë se ato kontrata kanë ekzistuar dhe vetëm janë bashkangjitur.

Andaj paneli shqyrtues konform Ekspertit Shqyrtues sqaron se AK ka vepruar konform LPP-së dhe RRUOPP-së, Citat:” 39.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, certifikatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. 39.6 AK do të caktoj afat kohorë të arsyeshëm për OE për sqarim të tenderit të tyre. 39.7 Nëse OE dështon të përgjigjet brenda afatit kohor të specifikuar nga AK tenderi përkatës do të refuzohet.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se njëri nga operatorët e OE të përzgjedhur kishte certifikatën e vjetërsuar të biznesit edhe pse ajo me UDHËZIMIN ADMINISTRATIV 01/2019 të datës 12.04.2019 PËR CAKTIMIN E KËRKESAVE, KUSHTEVE DHE PROCEDURAVE PËR KRIJIMIN E NR UNIK të shpallur në ARBK është kërkuar të ndërrohen certifikatat e vjetra me të ato të reja të cilat e përmbajnë tanimë NUMRIN UNIK IDENTIFIKUES.

Paneli shqyrtues duke pas parasysh faktin se tek kërkesa e DT. AK ka specifikuar si dëshmi Certifikatë të regjistrimit të biznes (kopje) konstatojmë se OE në fjale ka plotësuar kërkesën e tillë sepse AK nuk ka specifikuar certifikatë me afat andaj konkludojmë se ky pretendim i ankuesit është të pa bazuar, nga se kjo mund të konsiderohet edhe si devijim i vogël dhe ky devijim i vogël jo material nuk ndikon në ndryshim ose vendimmarrje pasi që shumë lehtë AK mund ta verifikoj një gjë të tillë në web faqen e ARBK-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Gjithashtu Paneli Shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues  
Nuhi Paçarizi



**Vendimi t'i dorëzohet:**

- 1x1 /AK/ "KK-Gjakovë" ,
- 1x1 / OE/ "Ndërtimi SH.P.K & Shkëmbi Gllarevë SH.P.K " Pejë ,
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.